

VENDIM
Nr. 544, datë 9.7.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË
ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT,
NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut I, bëhen shtesat e mëposhtme:
 - i. Pas emërimit “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike” shtohet “Qendra për Hapje dhe Dialog, “COD””;
 - ii. Pas emërimit “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar” shtohet “Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar”.
- b) Në lidhjen nr. 3, bashkëlidhur vendimit, pas pikës 29 shtohet pika 30, me këtë përmbajtje:
“30. Në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”, nëpunësit në pozicionet “titullar institucioni” dhe “drejtor drejtorie” të drejtorive të përmbajtjes, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.”.
- c) Lidhja nr. 8/1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- ç) Në lidhjen nr. 10, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat e mëposhtme:
 - i. Pas emërtesës “Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit” shtohet “Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”.”;
 - ii. Pas emërtesës “Kapiten i Portit” shtohet “Koordinator në Qendrën për Hapje dhe Dialog, “COD”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe fillojnë:

- a) nga data 1 korrik 2026, për përcaktimin e shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi;
- b) nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë, për të gjitha përcaktimet e tjera.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Qendra për Hapje dhe Dialog, “COD” dhe Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 8/1

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-2	1	90 000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-1	1	70 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbytjes në zyrën qendrore të AKSHI; Drejtor drejtorie të drejtorive IT të atashuara pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore.	II-1	1	70 000
Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.	II-1	1	0
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	III-1	1	50 000
Përgjegjës sektori në sektorët IT të atashuar pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore.	III-2	1	60 000
Përgjegjës sektori në sektorët e atashuar pranë drejtorive rajonale të sistemit tatimor.	III-3	1	40 000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbytjes në zyrën qendrore të AKSHI-t.	IV-1	1 ose 2	60 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë Kryeministrit, ministrive të linjës dhe pranë institucioneve qendrore; Specialist në sektorët e atashuar pranë degëve doganore.	IV-1	1 ose 2	60 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë IT të atashuar pranë institucioneve rajonale/vendore.	IV-3	1 ose 2, ose 3	55 000
	IV-4		
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2, ose 3	0
	IV-3		0